



Human Rights Review Panel

Buletini informativ # 8 – mars-prill 2014

- Seanca e 20^{të} e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Anëtarja zëvendësuese e Panelit në artikullin *Gratë në sundimin e ligjit*
- Ligjëratë për studentët në universitet
- Takim me kryetarin e Prishtinës
- Rritje e numrit të lëndëve në Panel

Seanca e 20^{të} e PShDNj-së

Seanca e 20-të e rregullt e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) është mbajtur në Prishtinë nga data 7 deri më 9 prill 2014. Paneli ka shqyrtuar 13 ankesa dhe ka marrë vendime në pesë lëndë. Katër ankesa janë shpallur të papranueshme, ndërsa në një lëndë Paneli ka refuzuar kërkesën e ankueses që të rishqyrtohej ankesa.

Vendimet e papranueshmërisë

Një prej lëndëve ([Rajovic kundër EULEX-it/2013-25](#)) e shpallur e papranueshme kishte të bënte me një kontest në mes të Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe një personi. Përderisa Paneli Këshillëdhënës i të Drejtave të Njeriut i UNMIK-ut ka vendosur se kishte pasur shkelje të të drejtave të njeriut në këtë lëndë, Paneli ka shpallur këtë lëndë të papranueshëm, pasi nuk ishte treguar se EULEX-i ishte përfshirë në ndonjë cilësi në këtë çështje. Prandaj kjo ankesë ka dalë jashtë kuadrit të kompetencave të Panelit. E njëjta mënyrë e arsyetimit ishte përdorur në vendimin tjetër të papranueshmërisë ([Vukovic kundër EULEX-it/2013-18](#)) në një çështje tjetër lidhur me pronën.

Lënda tjetër ([Maxhuni kundër EULEX-it/2013-24](#)) kishte të bënte me procedurat pranë Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës së Gjykatës Supreme të Kosovës. Paneli ka shpallur këtë lëndë të papranueshme, pasi në parim Paneli nuk mund të shqyrtoj respektimin e standardeve të të drejtave të njeriut të procedurave gjyqësore në gjykatat e Kosovës. Për të njëjtën arsye, Paneli ka shpallur një lëndë tjetër ([Gashi kundër EULEX-it/2013-22](#)) të papranueshme, ku ankuesi ka pohuar se ishte dënuar gabimisht nga gjykatat e Kosovës.

Vendimi për mos rishqyrtimin e një lënde

Në një lëndë ([J. kundër EULEX-it/2013-04](#)) ankuesja ka kërkuar që të bëhej rishqyrtimi i lëndës së saj, pasi ajo sugjeroj se Paneli kishte keqkuptuar parashtrirat e saj dhe nuk e kishte shqyrtuar ankesën e

saj që gjykatat e kishin humbur një dokument që ishte vendimtar në rezultatin e lëndës së saj gjatë procedurave në gjykatat e Kosovës. Paneli ka konkluduar se ankuesja nuk ka treguar asnjë dëshmi të re, sipas rregullit 42 të rregullores së punës dhe ka përsëritur se pavarësisht kësaj Paneli nuk kishte kompetenca për të vlerësuar as aspektet administrative (p.sh. trajtimin e dokumenteve) e as aspektet gjyqësore të punës së gjykatave të Kosovës. Prandaj, nuk ka pasur bazë për ta rishqyrtuar këtë lëndë.



Click Here!

Anëtarja zëvendësuese e Panelit znj. Elka Filcheva-Ermenkova është paraqitur në “Gratë në sundimin e ligjit” në faqen e internetit të EULEX-it. Ajo punon gjykatëse në Kolegjin e Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës në Gjykatës Supreme të Kosovës.



Që nga janari i vitit 2012, ajo vendos mbi kontestet pronësore që lidhen me konfliktin e armatosur të vitit 1998/1999.

Znj. Elka Filcheva-Ermenkova ishte emëruar anëtare zëvendësuese e Panelit më 15 janar 2013.

Prezentimi i PShDNj-së drejtuar studentëve të fakultetit juridik të universitetit AAB në Prishtinë

Më 26 prill 2014, me ftesë të dekanit të fakultetit juridik të universitetit AAB në Prishtinë, z. Muhamet Kelmendi, Panelit ju është dhënë mundësia që të informoj 80 studentë të fakultetit juridik rreth mandatit, punës, numrit të lëndëve dhe shkelleve të të drejtave të njeriut që janë konstatuar nga Paneli në disa lëndë.

Ligjërata ka ofruar një hyrje të shkurtër në marrëdhëniet midis të drejtave të njeriut dhe konceptit të sundimit të ligjit dhe ka trajtuar arsyen e themelimit të Panelit. Gjithashtu janë shtjelluar disa lëndë, për të cilat Paneli ka marrë vendime. Studentët kanë bërë pyetje në lidhje me pavarësinë e Panelit, ligjin në fuqi, si dhe efikasitetin e rekomandimeve të Panelit.




Zyrtar ligjor Florian Razesberger duke bërë prezantimin para studentët e fakultetit juridik në universitetin AAB në Prishtinë.

Fushata informuese: Takim me kryetarin e komunës së Prishtinës

Më 19 mars 2014 është mbajtur një takim me kryetarin e komunës së Prishtinës z. Shpend Ahmetin, në mënyrë që ta njoftoj atë mbi mandatin, procedurat dhe punën e Panelit, si dhe mbi numrin e lëndëve dhe shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it Kosovë, që janë konstatuar deri më sot nga Paneli.


Janë mbajtur takime të tjera me drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës z. Shpend Maxhunin si dhe me drejtorin ekzekutiv të Qendrës Evropiane për Çështje të Pakicave në Kosovë z. Adrian Zeqirin.



Nga e majta në të djathtë: z. John Ryan, zyrtar i lartë ligjor në PShDNj; z. Shpend Ahmeti, kryetar i komunës së Prishtinës

Rritja e numrit të lëndëve në Panel

Në katër muajt e parë të vitit 2014, Paneli ka pasur një rritje të konsiderueshme të numrit të lëndëve, me 29 raste të reja të regjistruara në mes të 1 janarit dhe 30 prillit 2014. Për krahasim, gjatë vitin 2013 Paneli kishte pranuar 27 lëndë gjithsej. Rritja e numrit të lëndëve është reflektuar edhe prej interesimit gjithnjë e në rritje për faqen e internetit të Panelit, që ka numëruar afër 4000 vizitorë nga 67 shtete gjatë muajit mars dhe prill 2014.



PARASHTRIMI I ANKESAVE

(Rregullat 25 dhe 26 të rregullores së punës të PShDNj-së)

Kush?

Çdo person i cili nuk punon për misionin e EULEX-it në Kosovë, i cili ankohet se ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e misionit të EULEX-it në Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Ankuesi (personi që e bën ankesën) mund të përfaqësohet nga ndonjë avokat ose përfaqësues tjetër sipas dëshirës së tij ose saj. Në këtë rast duhet të plotësohet autorizimi.

Çka?

Paneli do t'i shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me këto shkelje të dyshuara, të cilat kanë ndodhur në Kosovë pas datës 9 dhjetor 2008. Shkelja duhet të jetë shkaktuar nga misioni i EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Paneli nuk do t'i shqyrtojë procedurat gjyqësore të kryera nga gjykatat në Kosovë.

Kur?

Ankesa duhet t'i parashtrohet Panelit brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar.

Si?

Ankesa duhet të parashtrohet me shkrim. Ankesa nuk mund të bëhet me telefon. Ankuesi mund ta përdorë gjuhën angleze, shqipe ose serbe. Normalisht, ankesa duhet të plotësohet në formularin përkatës dhe të shoqërohet me dokumente dhe vendime përkatëse (nëse ka), sipas udhëzimeve në formular.

Nëse ankesa paraqitet me anë të letrës, në të duhet të përcaktohet, të paktën në formë të përmbledhur, lënda e ankesës në mënyrë që ajo të shqyrtohet më tej.

Ku?

Ankesa mund të parashtrohet në

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - Sekretariati

Rr. Rrustem Statovci; nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +381 (0) 38 78 2125

Ankesa gjithashtu mund të parashtrohet përmes postës elektronike në: office@hrrp.eu

www.hrrp.eu

Plotësimi i formularit për ankesë

Ankesa duhet të shkruhet qartë dhe lexueshëm, dhe mundësisht të jetë e shtypur me kompjuter.

Formulari duhet t'i përfshijë të gjitha hollësitë kontaktuese të ankuesit.

Nëse ankesa përmban fakte të dokumentuara, duhet të paraqiten kopjet e lexueshme. **Mos i dërgoni dokumentet origjinale.**

Dokumentet duhet të renditen sipas datës dhe të shënohen me numra rendor të njëpasnjëshëm dhe me një përshkrim të shkurtë (p.sh. letër, urdhër, vendim, ankesë, etj.).

Ankesës i caktohet numri i dosjes. Numri i dosjes duhet të përmendet në të gjitha korrespondencat vijuese. Nëse ankuesi tashmë e ka një ankesë, e cila është duke u shqyrtuar nga Paneli, ai/ajo duhet ta informojë Panelin lidhur me numrin e dosjes së mëparshme. Nëse ankuesi për arsye të ndryshme nuk dëshiron që identiteti i tij/saj të bëhet publik, ai/ajo duhet ta plotësojë pjesën përkatëse në formularin e ankesës.